

## Procesverbal

*Nga mbledhja e III - (tretë) e rregullt e Kuvendit Komunal në Dragash, e mbajtur më datë:*

### *Rend Dite*

1. Plani i Punës (Vazhdimi i pikës së IV-të nga seanca e kaluar),
2. Raporti Vjetor Financiar 01 Janar deri 31 Dhjetor 2022,
3. Miratimi i Rregullores për përcaktimin e Procedurave të Dhënies në shfrytëzim më pak se një (1) vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës,
4. Eventuale,

**Uran Halimi:** Përshëndetje të nderuar, nëse jemi gati po fillojmë seancën, mirë se keni ardhë në mbledhjen e tretë të rregullt për vitin 2023 të KK në Dragash, ku paraprakisht jeni konë të njoftuët në lidhje me rendin e ditës, e cila përmban në pikën e parë Planin e Punës, ku njëherit është vazhdimi i pikës së katërt nga seanca e kaluar, pikën e dytë e kemi raportin vjetor financiar 1 janar deri 31 dhjetor 2022, pika e tretë miratimi i rregullores për caktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, edhe e kemi pikën e katërt edhe të fundit, është eventuale. Duhet të theksoj se sa i përket procesverbalit në seancën e kaluar, për shkak të materialit i cili ka qenë goxha i madh edhe e dini që seanca na ka zgjat dy ditë, procesverbali është në përpunim e sipër nga Zyra e Kuvendit. Përpara se ta hedhim në votim këtë rend të ditës, ju ftoj që nëse keni dëshirë me e marrë fjalën dikush? Po, fjalën e ka kërkue z.Spahiu nga LDK.

**Mehmet Spahiu:** Përshëndetje kryetar, kryesues, asambleistë dhe asambleiste, media dhe qytetarë! Meqenëse Drejtorja e Arsimit ka mungesë të ni komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve, në konsultë me kryetarin dhe u.d. të drejtorit të Arsimit, dhe duke u bazuar në ligjin për arsimin parauniversitar, neni 35, pika 1,2,3, për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, propozoj emërimin e një komisioni për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në insitucionet edukativo-arsimore në Komunën e Dragashit. Sqarime rreth kësaj pike, propozimin do ta bëjë u.d. të drejtorit të Arsimit. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Spahiu! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën, sa i përket propozimit për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve. Raportimin mundeni me e bo mas vendimit për formim të komisionit. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkue z.Driton Ademi nga PDK.

**Driton Ademi:** Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Unë deshta kolegun nëse e lejon udhëzimi administrativ për me marrë pjesë na si komision, të Asamblesë, kushdo qoftë që zgjidhet. Domethënë, a lejohet na si Asamble me marrë pjesë në komision, në udhëzim administrativ për përzgjedhjen e drejtorëve? Po s'mundesh me propozue ti, përderisa në udhëzim administrativ nuk

ta lë, nëse kië udhëzim administrativ në të cilin lejon Asambleja m'u kyç për përzgjedhjen e drejtorëve, atëherë na mundim me ndikue. Faleminderit!

**Jetmir Ajdini:** Së pari është mirë me dalë u.d. i drejtorit të Arsimit me na spjegue arsyeshmërinë e këtij formimi të komisionit, e mandej vazhdojmë tutje. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Ajdini! Unë mora informacion që Kuvendi ka të drejtë me e themelue këtë komision. Ftoj u.d. të drejtorit për Arsimit që të na japë ni sqarim.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, të nderuar asambleistë, kolegë drejtorë! Sa i përket bazës ligjore e cila qëndron në lidhje me propozimin për futjen e rendit të ditës, ekziston udhëzimi administrativ numër 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor, për arsimin parauniversitar në RKS, procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe endërrimit të përkohshëm, më saktësiht neni 6, komisioni përzgjedhës, nëse më lejohet që ta citoj, pika tret e nenit 6 thotë: Komisioni përzgjedhës për për institucionet arsimore që janë në varësi të komunës, ka këtë përbërje, pika 3.1, dy anëtarë të komunës të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi Komunal. Anëtari i parë është i punësuar në DKA, ndërsa anëtari i dytë i propozuar nga DKA është njëri nga këta tre, që do të thotë duhet ta propozojmë njërin nga këto lëmi. Ekspert i pavarur i arsimit, drejtor i institucionit arsimor me performancë të lartë apo përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune, në fushën e edukimit. Sa i përket propozimit tonë, po procedojmë fillimisht ta shikojmë a po vendoset në rend dite dhe pastaj mund të ju jap arsyeshmërinë e kësaj pike. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, drejtor! Unë kërkoj 15 minuta pauzë edhe ftoj Zyrën e Kuvendit që të na printojë edhe të na shpërndajë krejt delegatëve këtë udhëzim në fjalë. Kthehem mas 15 minutave edhe e vazhdojmë seancën.

**Uran Halimi:** Faleminderit për pritjen, falënderoj Zyrën e Kuvendit për shërbimin që sapo e kreu. Vazhdojmë me seancën. Nëse ju vyen edhe pak kohë për me e lexue këtë udhëzim, nëse jo atëherë p'e vazhdojmë.

Të nderuar delegatë, unë sapo bëra pyetje edhe në MAPL, ma konfirmuan që ky UA është i vlefshëm edhe është në fuqi, edhe është udhëzimi i vetëm që përcakton komisionet për zgjedhjen e drejtorëve. Mundim me ec më tutje, a do me e marrë fjalën dikush në lidhje me këtë propozim? Fjalën e ka kërkuë z.Sejdilar dhe pas tij z.Jetmir Ajdini.

**Nedžmidin Sejdilar:** Përshëndetje të gjithëve, që kur kemi marrë mandatet, mendoj se në vitin 2021 kemi pasur tre seanca, në vitin 2022 kemi pasur 13 seanca dhe kjo është seanca e tretë në këtë vit me gjithsej 19 seanca dhe ende nuk kemi mësuar që për çdo pikë të rendit të ditës ose për çdo propozim pikë, ne marrim materialin shtatë ditë përpara. E kuptoj që vjen dikush nga opozita

dhe propozon plotësimin dhe ndryshimin e axhendës, por nuk mund ta kuptoj që qeveria nuk di çfarë të bëjë me veten. Është vërtet e pakuptueshme për mua që koalicioni qeverisës nuk di paraprakisht se çfarë të planifikojë. Ai erdhi këtu si nga frigoriferi dhe na ofroi disa komisione për zgjedhjen e drejtorëve dhe të ngjashme. Deri tani nuk mbaj mend të kemi pasur një takim pa na dhënë ndonjë material në takim. A ishte fjala për buxhetin, komisionet, udhëzimet administrative. Mendoj se kjo është krejtësisht e papërshtatshme dhe joserioze. Kërkoj që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për seancën e ardhshme.

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje edhe ni herë! Në emër të grupit parlamentar të VV-së kërkojmë që propozimi i z.Mehmet Spahiu të shtyhet për seancën e ardhshme, për shkak të vonesës për furnizim me material të asambleistëve, për shkak të mungesës së njohurive të anëtarëve të komisionit, edhe gjithçka që ka të bëjë me UA, t'u jepet kohë asambleistëve të lexojnë UA, edhe të njoftohen me anëtarët e komisionit të cilët do t'i propozojë Drejtoria e Arsimit. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Ajdini! Fjalën e ka z.Shpetim Hajredini nga PDK.

**Shpetim Hajredini:** Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar, të nderuar kolegë asambleistë, qytetarë të nderuar të Dragashit! Unë si shef i grupit të PDK-së natyrisht se nuk mund ta mbështes këtë pikë, e cila na erdhi tani që të futet në diskutim dhe në votim për këtë seancë. Andaj, kërkoj që të shtyhet për seancën e ardhshme, të kemi material më të detajuar, të kemi njohuri më të detajuara në këtë drejtim, dhe natyrisht që do të marrim edhe vendimin e duhur, nëse na lejohet që kjo pikë të diskutohet në seancën e ardhshme. Në të kundërtën, nëse vetëm vazhdohet dhe votohet në këtë seancë, ne si grup nuk do ta mbështesim dhe jemi kundër. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Falemindert, z.Hajredini! Mu më duhet të theksoj se Ligji për vetëqeverisje lokale ka të bëjë me futjen e një pike në rend të ditës, dhe futja bëhet vetëm atëherë kur është e rëndësishë të veçantë, në të mirën e përgjithshme për qytetarët edhe është shumë me urgjencë. Tash, qysh të mendoni ju. Gjithashtu, UA e ka theksue qartë mënyrën e formimit të këtij komisioni, e shtyjmë ose nuk e shtyjmë është veç humbje kohe, se procedurat janë të përcaktume me UA, nuk mund me ndryshue diçka nëse e bëjmë sot ose e bëjmë mas ni muaji. Janë procedura të përcaktume nga udhëzimi të cilin veç e keni ju. Në rregull, atëherë unë do të t'i qes në votim propozimet, edhe në fund e qesim në votim edhe rendin e ditës me propozimin për futjen e kësaj pike. Do me thënë, e kemi me e qit propozimin për shtymje ni herë, a po? Fjalën e ka kërkuë z.Spahiu.

**Mehmet Spahiu:** Kur është fjala për zbatimin e ligjshmërisë, ne duhet të jemi shumë të përgjegjshëm. Propozimi ynë ka të bëjë me zbatimin e ligjshmërisë, edhe këtu besoj që nuk varet nga vullneti i asambleistëve ta shtyjmë ose mos ta shtyjmë. Është një çështje që e kërkuat si asambleistë të na ofrohet UA, udhëzimi na u ofruë, edhe shumë qartë po e precizon se çfarë po kërkohet, edhe nëse ne si asambleistë e shtyjmë këtë pikë të rendit të ditës, unë mendoj që nuk

jemi të përgjegjshëm në nivelin e duhur. Andaj propozoj, kryesues, që propozimi im të futet në kuadër të propozimeve. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Të nderuar delegatë, të dy kërkesat e kanë të njëjtin qëllim, nëse e merr shumicën e votave propozimi që duhet m'u vazhdue, atëherë hidhet automatikisht poshtë propozimi i palës tjetër. Sa i përket ligjshmërisë ose jo të këtij vendimi, na s'e përcaktojmë atë se e dërgojmë në MAPL. Nëse s'është i ligjshëm, edhe nëse na e procedojmë, ai na kthehet prapë. Kështu që s'është diçka që është absolut, kjo mundën edhe me ndryshue. Fjalën e ka kërkuar z.Agron Gashi nga AAK.

**Agron Gashi:** Atëherë ju përshëndes të pranishëm, përshëndetje kryetar, përshëndetje kryesues dhe ju kolegë asambleistë! Paraprakisht drejtori i mahershëm foli dhe u.d., e përcaktoi se çka kishim të drejtë dhe çka nuk kemi të drejtë. Thuhet shkurt, thjesht, se kandidatët dhe komisioni janë të propozuar nga DKA. Njëri kryekëput që është i DKA-së aty në brendi, dhe një tjetër është një kandidat që e propozon DKA, por thamë që me një performancë të punës në lëminë e arsimit, dhe nga ana tjetër përmendi edhe këshillin e prindërve i cili edhe aty merret në konsideratë. Dhe nuk krijon shumë dilema tash, sot apo nesër apo në seancën e ardhshme, është shkurt e thjesht që DKA i propozon kandidatët dhe që neve duhet t'i kryjmë procedurat e votimit në këtë seancë, kaq. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Gashi! Sa i përket procedurave, ne po vazhdojmë me i fut në rend të ditës. Atëherë, së pari po e fusim në votim propozimin për shtyrje të kësaj, ose po e fusim propozimin e parë, se është e njëjta. Z.Samidin Xheladini fjalën e ka.

**Samidin Xheladini:** Ju përshëndes të gjithëve të pranishëm! Kryesues, neve na dhatë ni material që duhet ta debatojmë edhe ta shqyrtojmë. Na e kemi para vetit, na vyn ni minutë kohë me lexue pikën 3.1, për dy minuta kohë na jemi në gjendje me e shqyrtue këtë edhe me vendos. Na jemi për atë punë, jemi të zgjedhur për me i shqyrtue të gjitha problematikat. Kolega i nderuar çdo mbledhje propozon ka dy-tri pika të rendit të ditës, të cilat nuk kanë rëndësi fare, tash thotë se pika nuk është urgjente. Sigurisht që është urgjente, çdo çështje është urgjente, na jemi këtu për me i trajtue pikat, të gjitha. Prandaj unë jam i mendimit që me e hedhë në votim, nëse kalon, nëse s'kalon mirë, ni minutë kohë ka këtu, s'ka më shumë.

**Uran Halimi:** Ishin tre propozime, nuk ishte vetëm një, po na po e procedojmë, edhe propozimet duhet t'i qesim, varet se si janë propozuar, domethënë së pari e hedhim në votim propozimin së pari të kolegut Mehmet Spahiu, kush është pro këtij propozimi për emërimin e këtij komisioni, për futjen në rend të ditës të propozimit? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë konstatoj që me 13 vota pro, me 11 kundër dhe zero abstenim, kalon propozimi i z.Mehmet Spahiu. Po vazhdojmë me rendin e ditës, duke e pasur edhe si pikë propozimin për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave. E qesim në votim rendin e ditës, kush është pro këtij rendi të ditës? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë 13 vota pro, 10 kundër edhe zero abstenim, kalon edhe ky rend

i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë, e kemi planin e punës, vazhdim i pikës së katërt nga seanca e kaluar. Kush do me e marrë fjalën në lidhje me planin e punës të cilin ju veç e keni të servuar nga Kuvendi. Nëse nuk ka dikush me e marrë fjalën, na mundim me vazhdue radhën të cilën e kemi pas, e kemi drejtorin e Administratës të parin i cili ka raportue në seancën e kalume, nëse do me e marrë fjalën dikush nga kjo drejtori? Nëse jo, atëherë vazhdojmë me Drejtorinë e Ekonomisë, nëse duesh me dhënë ndonjë sqarim mundeni me e marrë fjalën. Po më duhet për shkaqe procedurale me e ricek radhën se si keni raportue ma herët. Raportet ekzistojnë, janë në rend të ditës, veç nëse do me e marrë fjalën me shtue dikush diçka, në lidhje me planin domethënë të punës. S'ka, okej. Nga drejtoritë tjera, a t'i cekim krejtë me rend? Pastaj e kemi DKRS, drejtoresha s'po do me e marrë fjalën, e kemi Drejtorinë e Shërbimeve Publike, nuk kemi ndonjë përfaqësues, e kemi urbanizmin, jo, atëherë e kemi Zyrën për Komunitete dhe Kthim, nuk ka plan të punës kjo po më njoftojnë, edhe barazia gjinore nuk ka, e kemi DKA-në, s'është këtu, edhe e kemi të Shëndetësisë. Nëse jo, atëherë...okej, hajde, mundish me e marrë fjalën.

**Nedžmidin Sejdlar:** Faleminderit, kryesues! Më duket që ndonjëherë nuk po e kuptojmë njëri-tjetrin këtu, a është për shkak të përkthimit a çka është puna s'e di. Këtu na e kemi pa joseriozitetin e pushtetit, që asnjëri prej drejtorëve s'ka pas guxim me ardhë këtu në foltore me tregu karshi qytetarit planin e veprimit për vitin 2023. Po ashtu në material, masi tha kolegu kemi planin zi edhe bardhë, nuk e kemi planin të Zyrës për Komunitete, unë një qeso plan nuk e kam pa në material edhe s'kam mujt me lexue. Kjo pika sot tregon një joseriozitet edhe tregon që fjalët e mia po dalin të vërteta. Siç i thashë kryetarit ma herët, këshilltarët i ka shumë të dobët. Unë nuk dyshoj te qëllimi edhe sinjeraliteti i kryetarit, po po shihet që edhe luftëtarët më të zëshëm janë duke hequr dorë prej posteve. Unë mendoj që duhet pak me tregu seriozitet karshi qytetarit, edhe bile kryetar me dalë me na tregue ndonjë plan, a kemi plan për vitin 2023 a s'kemi. Qato që e kemi në letër unë nuk muj me ju besu, se çdo ditë ndonjë letër na jepni, ndonjë letër na merrni, e kemi pa edhe shembullin e buxhetit në seancën e kalume, 5 lloj të buxhetit e kemi pa, qekjo është totalisht joseriozitet. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Sejdlar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkue z.Nexhat Selaj nga PDK.

**Nexhat Selaj:** Përshëndetje kryetar, kolegë asambleistë! Me vëmendje të përcolla deri më tani, edhe shumë mirë kryesues që ftove drejtorët e drejtorive që të raportojnë, të japin parashikimet për vitin 2023. Pasi që veç i përkas fushës së arsimit, deshta të ndërlihem këtu, thashë të shoh çka po na raporton edhe drejtori, po drejtori n mungesë, 65 mijë euro të ndara për për shkollën e mesme të lart 'Ruzhdi Berisha', çfarë projekte ka dhe çfarë do të rregullohet. Pata edhe shumëçka, po masi s'e kemi këtu prezent, nuk po due që të flas, vetëm po kërkuj qeto investime prej 65 mijë euro çfarë kanë planifikue që të ndërtohet. E dyta që më bren gjithmonë edhe kam kërkue, kam has në mirëkuptim me drejtorin, mirëpo prapë s'e kam këtu, në planin vjetor 2023 që ka premtue kuizin e diturisë nuk e kemi në plan. S'po kam prej kujt me lyp përgjigje, kush me më kthye përgjigje.

Isha ndalë te Shëndetësia, te drejtori i Shëndetësisë, kur nuk del me raportue për 2023, kur ne nga informacione shumë të sigurta, edhe nga vetë nevoja ime që isha para disa ditëve, nuk kemi ose na mungonë pajisjet sanitare higjienike, duke përfshirë këtu edhe letrat e pastrimit, dezinfektimit etj. Nëse nuk mund me dalë drejtori, unë i kisha bo edhe ni kërkesë, ni lutje kryetarit, se vetë i takon asaj fushe, me këto tenderat, ka dështue njëri tender, po dështon edhe tjetri, qytetarët në hall, vetë, për sanitari, mos të flasim për elementet tjera. Ma shumë kisha për arsim, po masi s'e kam kolegun këtu. Do të isha ndalë pak, ni revansh të vogël z.Mehmetit, tha duhet të kalojë kjo pikë e gjashtë, është përgjegjësi e jona. Përgjegjësi, ta Mehmet, nuk është e jona, është përgjegjësi e juaja, se e bini rendin e ditës brenda seancës, do të thotë kjo nuk është përgjegjësi e jona, kjo është përgjegjësi e juaja, kështu që u ndjeva pak i fyer, po këtë detyrimisht u dashtë me ta thënë. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Selaj! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkuë z.Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë përshëndetje edhe ni herë për të gjithë! E thanë edhe parafolësit e mi që është dashtë drejtorët të jenë pak më seriozë, edhe të marrin fjalën paraprakisht dhe të paraqesin para nesh planin e punës për 2023, edhe pse si material na e kemi, të gjithë ata që kanë dëshirë ta lexojnë, e kanë lexue, por kishte qenë më e moralshme dhe më e përgjegjshme që edhe ata, ni pjesë e tyre të dalin në foltore dhe të na paraqesin edhe pak më të detajuar planin e tyre se çka do të punojnë për vitin 2023 për të mirën e qytetarëve. Unë do të lidhem pak te Drejtoria e Bujqësisë, drejtori të cilën, nëse kam ymer edhe këto tri vite të jem në këtë pozitë, do të mundohem gjithmonë të flas, derisa ta shoh se kjo drejtori është në rrugën e duhur dhe gjendet pranë qytetarëve dhe i plotëson nevojat e tyre. Në planin të cilin e kam lexuar në detaje, kam shikuar se në këtë plan, e kam përdorur vitin e kaluar ni shprehje, copy-paste. Edhe këtë vit shumë pak, pothuajse vetëm janë largue disa pika, ndërsa shtesë diçka nuk kam vërejtur. Si kriteret e tyre kyçe po vazhdojnë ato të njëjtat të vitit të kaluar, ndërsa nevojat dhe kërkesat e qytetarëve çdo vit po ndryshojnë. Prandaj edhe përqendrimi i drejtorave edhe i buxhetit natyrisht do të duhet të ndryshojë, në të kundërtën do të bëjmë hapa mbrapa. Mirëpo në këtë plan, për mendimin tim, është lënë i vitit të kaluar dhe nuk shoh ndonjë zhvillim të hovshëm apo ndonjë nisje që do të shohim dritë fermerët, do të shohim se kjo drejtori punon për të mirën e tyre, dhe ka një shpresë të mos largohen nga fshatrat, mos të largohen nga lëmia e tyre, që është tejet e ngarkuar. Por për fat të keq, kjo edhe këtë vit, në bazë të këtij plani, unë jam shumë skeptik se do të ketë ndryshim dhe do të ndikojë diçka në të mirën e qytetarëve të cilët merren me blegtori dhe bujqësi. Po vazhdoj pak, pasi këtu edhe e kemi drejtorin e Financave dhe jemi të të njëjtës lëmi. Kam lexuar planin e punës edhe të drejtorit të EFZH, dhe do të përqendrohem pak tek, pikën e nëntë e kie të shënume, i nderuar drejtor, përgatitja dhe hartimi i strategjisë për zhvillim ekonomik lokal. Shumë në rregull, ne e dimë që jemi në një periudhë kohore edhe të përgatitjes së planit për 10 vite. Por tek përshkrimi i detyrave të planifikuara, nuk e kam vërjet diku naj punë që ka lidhje me zhvillimin ekonomik. Ndërsa sa i përket pikave dhe kriterëve të tjera, po, janë në rregull. Edhe diçka që më ra në sy është shpërndarja e faturave të tatimin në pronë shkurt-mars, unë s'pe di a ke fillue me i lëshue faturat a

jo, kish qenë mirë me ma dhënë një përgjigje, nëse keni filluar mirë, nëse jo, kjo nuk qëndron. Gjithashtu, qetu e kam vërejt, kjo është ndoshta ni lëshim gjuhësor, por që më ra edhe kjo në sy dhe nuk m'u dok si përshkrim i duhur, te pika e 27-te këtë ndarje që e ke bo, shqyrtimi i raportit për realizimin e buxhetit për periudhën janar-shtator 2023. Shqyrtim s'po di a është fjalë adekuate, kish qenë ma mirë përgatitje ose diçka, se shqyrtim nuk po ma rrok që bëni shqyrtimin e raportit, a përgatitje po, andaj kjo fjalë për mendimin tem duhet të hiqet dhe të zëvendësohet me përgatitje. Për tjerat jemi në rregull dhe dhashtë Zoti i realizoni kështu siç i keni planifikuar. Drejtorja e Mbrotjes, Shpëtimit dhe Shërbimeve Publike për vitin 2023. Nëse e kemi drejtorin, veç një pyetje të shkurtë, nëse ka mundësi me na dhënë përgjigjen pse ka ndodhur rritja e faturave nga Ekoregjioni, dhe janë fatura shumë të fryra tani për bizneset dhe janë të ndara në grupe, po janë shumë të larta kur dihet se qytetarët vetëm gjenden në një kolaps financiar, tani është bërë edhe kjo ngarkesë, nëse ka mundësi drejtori të më përgjigjet në këtë pyetje kishte qenë mirë, pse ka ndodhur kjo rritje. E di që arsyetim e ka naftën, po nafta tani ka ra, edhe duhet prapë të merret një vendim dhe të ulen pak këto. Zyra për Komunitete dhe Kthim e tha edhe kolegu që planin e punës nuk e kemi fare dhe nuk e di se çfarë punë do të kryejë ky drejtor në vitin 2023. Gjithashtu, diçka që e kam vërejt se nuk është në rregull, shumica e planeve të punës nuk janë të nënshkruara, është mirë më i nënshkrue edhe me i protokolue edhe planet e punës, edhe pse nuk dyshojmë në atë që janë të përgatitura dhe të finalizuara nga vetë drejtorët, por është e ligjshme që të jenë të nënshkruara dhe të protokoluara, si disa prej drejtorave që na kanë pru planin e punës shumë të kompletuar dhe të detajuar. Ju falemnderit!

**Uran Halimi:** Falemnderit, z.Hajredini! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkuar z.Jetmir Ajdini.

**Jetmir Ajdini:** Përshëndetje edhe ni herë! Kur flasim për raportin financiar për ni vit të buxhetit komunal, po e shohim që shumica e drejtorëve nuk janë prezent, edhe ata që janë nuk e marrin fjalën edhe me spjegue për projektet, me dalë edhe me iu tregue qytetarëve ku do të shpenzohen paratë e buxhetit komunal. Asnjëri prej tyre nuk na dha asnjë shpjegim për cilat projekte bëhet fjalë, ku do të investohen, përveç ne si asambleistë që i kemi të dhënat, do me thënë e kemi qet material, qytetarët nuk janë të informum absolut nga drejtoritë përkatëse se ku do ta shpenzojë qeverisja komunale buxhetin komunal. Falemnderit!

**Uran Halimi:** Falemnderit, z.Ajdini! Fjalën e ka kërkuar drejtori... nëse s'ka pyetje të tjera, patjetër, a ka dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën para se me dalë drejtori për Ekonomi dhe Financa? Atëherë drejtor mundesh me e marrë fjalën.

**Qamil Kolloni:** Përshëndetje kryetar, përshëndetje delegatë, të gjithë të pranishëm dhe ju media, përshëndetje kryesues! Më vjen mirë që delegatët parashtruan disa pyetje, na shkuem nga racionalizimi i kohës që planin realisht ai i cili është paraparë në shtylla të trasha, dhe të cilin e keni pas dhe keni pas mundësi ta lexoni, mos ta duplifikojmë që të bëjmë dy herë interpretime, ni

herë të dalim, e pastaj të diskutojmë. Po realisht aty ku kemi bo ndonjë lëshim do të ishte mirë edhe është mirë që edhe na e cekët, edhe mund ta shtjellojmë. Aspak nuk hezitojmë që të dalim edhe këtu të thona edhe të diskutojmë edhe ta paraqesim planin. Por t'u e pas parasyssh se atë plan e keni pas të gjithë edhe e keni lexue, për mos me ju marrë shumë kohë, e lamë që të shkojmë me pyetje interaktive, ju mund të pyesni na mund të përgjigjemi. Dhe ai plan i mban disa kontura ligjore dhe afate ligjore prej të cilave nuk dalim. Po shkojmë me radhë. Sa i përket pyetjes së Shpetimit për strategjinë e zhvillimit ekonomik, Shpetim, këtë vit del apo skadon edhe afati i Planit Zhvillimor Komunal, neve kemi bo kërkesë që, edhe jemi në kërkim e sipër, gjithashtu edhe ndihmën e ministrisë e kemi këkrue, që sivjet ta realizojmë Planin Zhvillimor Ekonomik të Komunës së Dragashit. Në kuadër të këtij plani, dalin edhe strategjia për zhvillim ekonomik, edhe profili komunal, po gjithashtu tash edhe nga ministria e turizmit që është krijuar si ministri ma e re, kërkohet edhe strategjia për zhvillimin e turizmit. Të gjitha këto shkojnë në një pako dhe na duhet një kompani e cila ka ekspertizë në këto drejtime, që të realizojmë një plan qysh e kemi pas planin e parë, shumë të mirë të krijuar nga UNDP, dhe për fat të keq këtë vit skadon dhe na duhet ni plan i ri. Jemi në kërkim të donatorëve, jemi në kërkim edhe të organizatave të cilat kanë ekspertizë në këtë drejtim, dhe besoj se nuk e kemi qit jashtë mendsh. Sa i përket se në planin zhvillimor nuk kemi parapa diku rreth çështjes së zhvillimit ekonomik, politikat të cilat orientohen në investime kapitale, realisht, në mënyrë cirkulare ti e dish që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Mirëpo, për me qenë modest edhe për mos me u livdue, na në BE kemi kaluar zyrën për zhvillim të turizmit, edhe për zhvillim të ekonomisë drejtpërdrejt në fazën e parë, jemi në fazën e dytë dhe shpresojmë që ta kalojmë edhe këtë që është gati ni investim diku gjysmë milion euro. Pritet që këtë vit të realizohet dhe nuk kemi dashtë që me hamendje ta paraqesim në planin e punës, po në momentin kur do ta konkretizojmë atëherë do ta shihni edhe ju. Sa i përket ndarjes së faturave, deri më tash ka qenë praktikë të cilën ni pjesë të faturave e kanë shpërnda punëtorët e tatimit në pronë, këtë vit kemi bo marrëveshje me postën e Kosovës, dhe të gjitha faturat të cilat i nxjerr Qeveria e Kosovës nga tatimi në pronë, ndahen nëpërmjet postës dhe na i presim vërejtjet prej 31 marsit deri më 15 prill. Realisht, ni pjesë e faturave kanë filluar të ndahen, kemi has edhe vërejtje për shkaqe të gabimeve teknike, a të postës a të qeverisë nuk kemi marrë përgjigjen adekuate. Kemi bërë kërkesë që të na japin sqarim, kemi raste kur na paraqitet i njëjti klient me dy fatura, mund të jenë gabime në qeveri, se edhe atje janë njerëz, po mund edhe t'i duplikojnë ndoshta në postë, në momentin kur i shtin në zarfe për m'i shpërnda, mirëpo edhe këtë jemi në vazhdimësi duke e përcjellë. Investimet kapitale, doktor unë deshta shumë thjesht me t'u përgjigj, investimet kapitale ju si delegatë i keni miratue vitin e kaluar dhe janë miratue nga qeveria. Tash ju po bëni një pyetje kur sot nuk është këtu në rend të ditës, në qoftë se duesh na ta marrim pasqyrën apert ta lexojmë, prej të parit investim deri te i fundit. Do të ishte shumë e tepërt kjo. Unë mendoj se të njëjtat investime kapitale të cilat kanë qenë për secilin drejtorat veç e veç, është miratue vitin e kaluar nga qeta delegatë dhe këtë vit punohet. Keni pas prezent materialin, besoj se qaq jeni në dijeni edhe në memorie sa ta dini se i keni miratue të gjitha investimet kapitale për këtë vit. Dhe në qoftë se fillon në secilën seancë edhe dalim jashtë rendit të ditës, bëjmë kërkesa për diçka tjetër, unë mendoj se nuk jemi mirë me kohën. Po në qoftë se kie nevojë, unë mund ta marr edhe listën, për secilin



investim veç e veç, edhe vlerën monetare, edhe të gjitha mund t'i shihni. Po na po mendojmë se e kemi ofruar në plan të cilin ju përfaqëson si delegatë jeni të njoftuar, se përpos punës së përditshme kemi edhe disa shtylla ligjore me të cilat secili drejtorat funksionon dhe vepron. Prandaj, po më vjen mirë që në qoftë se keni vërejt nga ato plane të punës së drejtorëve që keni arsye me bo pyetje, do të ishte mirë të bëni pyetje dhe gradualisht t'i shtjellojmë edhe çështjet për të cilat kemi nevojë. Faleminderit!

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm! Raporti i punës dhe plani. Me raportin e punës i kemi hup kohë dy ditë për me elaborue dhe ishte shumë e mirëseardhur, po në planin e punës e kemi për obligim na që të gjitha, në qoftë se ka lëshime, dobësi, qeveria dhe drejtoratët, na t'i propozojmë edhe të inkorporohen në planin e punës për vitin 2023. Asnjë propozim konkret. Raporti është voluminoz dhe ka 134 faqe te gjuha shqipe ndërsa te pjesa e minoriteteve përmban ma pak, për shkak të përkthimit. Këtu u përmend mes tjerash, koha e kaluar, na duhet të kemi kujdes, koha e kaluar, koha e tashme dhe e ardhshme. Te raporti i punës së Zyrës për Komunitete është shumë decidivisht edhe e kaluara edhe e tashmja edhe e ardhshmja. Koha e kaluar domethënë parasheh aktivitetet që janë krye, dhe koha e ardhshme çka parasheh që të realizohen. Qe për shembull, luftimi i çdo lloji të diskriminimit të komunës tonë, domethënë në të ardhmen, është përfaqësimi i barabartë i komuniteteve në institucione të komunës. Koha e ardhshme, ka të bëjë me kohën e ardhshme. Kthimi i qëndrueshëm i personave të shpërngulur dhe pesonave të riatdhesuar, prapë koha e ardhshme, domethënë për planin e ardhshëm. Mbledhja e të dhënave për gjendjen e minoriteteve dhe nevojave të tyre, realizimin e përqindjes në arsim, shpërndarjen e buxhetit, propozimet për investime kapitale, domethënë në kohën e ardhshme të gjitha, përdorimin e barabartë të gjuhës, informimin e qytetarëve dhe demografisë, s'e di këtë demografisë po është e shkrume. Pra ka të bëjë, kur ta lexojmë duhet ta dimë, koha e kaluar, e tashme dhe e ardhshme, domethënë këtu unë u preka kur tha plani i punës, edhe u detyrova edhe një herë me e lexue. Nedzmidini ka përmend që s'ka plan, plani është shumë konkret po ai nuk e ka lexue, po më vjen keq, le ta lëxojë mirë.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Samidin Xheladini! Dikush tjetër nëse do me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, është fjala për pikën e parë për planin e punës, kush është pro këtij plani të punës? Kush është kundër? Abstenim? I kemi 12 vota pro, kemi zero kundër dhe 8 abstenime. Kalon pika e parë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dytë, e kemi raportin vjetor financiar 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit 2022. Atëherë ju ftoj që me e marrë fjalën, nëse ka dikush që do me e marrë fjalën. Nëse nuk ka prej asambleistëve që dojnë me e marrë fjalën, unë e kisha ftue drejtorin me na raportue pak a shumë.

**Qamil Kolloni:** Të nderuar delegatë edhe ni herë! Unë nuk due të luaj rolin edhe ta lexoj, besoj se të gjithë e keni lexue, unë do të mundohem veç në pika të shkurta të ju jap disa sqarime. Unë mund të ju them se është një prej raporteve ma progresive vitet e fundit që ka pas kjo komunë, Komuna e Dragashit. Nuk e them këtë për lavdata, ka ndodhë çka ka ndodhë. Ky raport është në kuadër të

SIMFK, të gjitha të dhënat nuk mund të ndryshojnë, janë në sistem, janë këto të cilat janë. Sa i përket, në përgjithësi ju edhe në raportet patët mundësi që dhatë vërejtje për dy ditë, për punën, mospunën, shpërndarjen e mjeteve, mosshpërndarjen e mjeteve, vetëm më ka mbet një përgjigje pa ia dhënë, për fakin se për 17 mijë euro të shkollës së Brodit është bërë shumë bisedë, sot e keni në raport, mund ta lexoni se ato mjete nuk kanë shkue të kompanitë, operatorët ekonomikë, dhe ato mjete janë kthye në suficit, prandaj nuk ka qenë mirë që të krijoni edhe të bëni politikë këtu edhe ta atakoni drejtorin e Arsimit në atë seancë. Unë nuk deshta ta individualizoj, është me rëndësi që të jemi korrekt në këto sende, për arsye se 17 mijë euro ni shumë bukur e madhe, dhe tash në raport ju keni mundësinë ta shihni aty në mënyrë detale se ato mjete janë kthye në suficit dhe mjetet të cilat i ka investue CIMIC-u janë për me i falënderue dhe ai investim sot e kësaj dite është në rregull. Unë besoj se kemi pas edhe biseda të vazhdueshme në secilën seancë, mendoj se janë shterrë, në qoftë se keni diçka më konkrete, na mund t'jau japim ma konkrete, mirëpo këto të dhëna janë të dhëna faktike, të cilat nuk mund t'i ndryshojmë as ju, as na. Këto janë ato transaksione të cilat kanë ndodhë gjatë vitit 2022.

**Uran Halimi:** Faleminderit, drejtor! Fjalën e ka kërkuar z.Nexhat Selaj.

**Nexhat Selaj:** Faleminderit edhe ni herë! Tash unë nuk po muj të kuptoj shumë në rregull, nuk po due të shprehem në mënyrë të tillë, po kjo seancë po reflekton në mënyrën e tillë, kryetar si përgjegjës për të gjithë këtë kabinetin, drejtorët po të mungojnë, po duhet me na dhënë përgjigje. E kërkoja ni përgjigje për 65 mijë eurot për shkollën 'Ruzhdi Berisha', çfarë investimi është parapa të ndërtohet. Ne kemi 5-6 projekte të cilat kemi bo, a munë të na ofrojë dikush një të dhënë se çfarë është parapa aty. Për kuizin e diturisë që po thoni, po falënderoj z.Qamilin që me atë forcën çfarë po e ka, po del edhe po debaton edhe po e ka një arsyeshmëri. Drejtorët tjerë, kush me më dhënë përgjigje, e kërkoja nga ju si vetë mjek, në shëndetësi nëse nuk ka çka të flitet hiç, thamë se mungojnë edhe pajisjet sanitare higjienike, me ni tender po e di se ka dështue, tash pjesa e dytë e tenderit çfarë po ndodh. Qamilit veç pak, sa për rikujtim, te këto 17 mijë e 800 eurot sa ishin, këto Qamil na po e kuptojmë se paret ndoshta kanë dalë në suficit, na keni përcjellë materialin, por ajo të cilën është debatue në atë kohë, ka figurue si para e hargjuar, ndërkohë ajo është kryer nga CIMIC-u gjerman, për në atë kohë ka qenë e tillë, tash keni pru material se ato janë para të kthyera mbrapa, krejt është okej. Unë po kërkoj nga drejtorët që të dalin të raportojnë secili për fushën e vet, që ne të kemi elemente që të flasim. Përderisa ne nuk i kemi drejtorët këtu, çfarë mund të flasim. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Selaj! Sa i përket asaj pyetjes të kuizit të diturisë, na e kemi edhe u.d. të drejtorit të Arsimit këtu, po besoj që mundën me ta dhënë një përgjigje. Zotëri u.d. i DKA-së, a mundesh me ia dhënë një përgjigje?

**Vetim Ramadani:** Faleminderit kryesues, të nderuar asambleistë! I nderuar prof, në lidhje me fjalën tënde që na apostrofove, me arsyetimin që na nuk qendrojmë këtu, besoj se dëshmia ma e

madhe është incizimet, të gjithë drejtorët thuajse në çdo seancë jemi të pranishëm këtu. Me aq sa ne mundohemi, kemi informacione, debatojmë, diskutojmë, shikojmë zgjidhje, pranojmë ndonjëherë kritika, replikojmë, të gjitha besoj i bëjmë në kuadër të përmirësimit të qeverisjes. Na nuk jemi perfekt, mirëpo megjithatë jemi duke e bërë maksimumin që me punue dhe me e realizue ni plan të punës të cilin, ne si qeverisje lokale, e kemi planifikuar me kohë. Sa i përket investimeve në DKA, përkatësisht në shkollën ‘Ruzhdi Berisha’, të cilën ju e apostrofuat më herët, meqenëse jam i ri si u.d. i drejtorit të Arsimit, më lejoni të ju theksoj se qëllimi i ndarjes së këtyre mjeteve ka qenë renovimi i hapësirës që gjendet në mes të objektit të gjimnazit ‘Ruzhdi Berisha’, besoj ju e dini shumë mirë për cilën pjesë është fjala, është fjala për sallën, e cila planifikohet, meqenëse kompania projektuese tashmë është shpallur fituese nga Zyra e Prokurimit, shumë shpejt, besoj që javën tjetër do të dalin të bëjnë matjet në teren dhe të hartohet projekti detal. Dhe, përveç këtyre, një pjesë tjetër e cila do të mbet nga ato mjete, do të orientohet në rregullimin e hapësirave gjelbëruese në gjimnazin ‘Ruzhdi Berisha’. Sa i përket mjeteve higjienike, furnizimi me material dhe gjendjen në shëndetësi, kontrata e cila ka qenë valide ka skaduar, pasneër përfundon afati i ankesave dhe nënshkruhet, tashmë fituesi dihet, mirëpo megjithatë janë afatet ligjore të cilat ne duhet t’i respektojmë, dhe nënshkruhet kontrata me kompaninë e cila do të bëjë furnizimin njëvjeçar për material higjienik, jo vetëm për QKMF-në, për administratën komunale, DKA-në, të gjitha shkollat fillore dhe gjimnazin. Duhet theksuar se gjendja në shëndetësi, jam plotësisht dakord me ju, se është pak më kritike, meqenëse niveli i pastërtisë gjithkund duhet të respektohet, mirëpo në qendrat e mjekësisë familjare duhet të jetë në nivelin mbi standard, mirëpo ajo gjë do të sanohet shumë shpejt. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit! Unë me sa e kuptova pyetja ke shumë konkrete, te premtimi i realizimit të kuizit të diturisë, kuizi i diturisë dy herë u përmend, sidoqoftë s’prish punë. Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? E ka kërkue fjalën z.Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë përshëndetje edhe ni herë për të gjithë! Në katër vitet e kaluar, sa herë na vijke raporti vjetor financiar, këta kolegët e mi që i kam sot, njëri prej tyre gjithmonë shkojke tek shpenzimet dhe mallrat, dhe i merrke këtu shifrat, i shikojke, bojke krahasime me vitin e kaluar. Gjithmonë e kam thënë ky është raport financiar i përfunduar, qoftë i mirë apo i keq ky është i përfunduar dhe s’mujm me e ndryshue. Në këtë moment ky raport për mu, këto shifra janë ma të mira të mundshme, dhe buxheti është realizuar siç është më së miri. E kam thënë në fillim që nëse në fund të vitit e tejkaloni dhe arrini ta mirrni grantin e performancës, unë do të ju uroj. Edhe natyrisht që unë e mbaj fjalën. Ju uroj dhe dhashtë Zoti edhe vitin e ardhshëm të arrini në të njëjtin nivel, se këto pare janë të popullit dhe po kthehen te populli, qoftë diku në të mirën e tyre apo edhe jo në të mirën e tyre, por gjithmonë po besoj që planet dhe qëllimi është i mirë. E dhashtë Zoti që edhe këtë vit natyrisht do të arrini dhe të realizoni buxhetin dhe të përfitoni prapë grantin e performancës, dhe unë nuk do të hyj tash t’i lexoj shifrat, pasi që e kam kundërshtuar në katër vitet e kaluar dhe nuk më përket mu që tani të merrem dhe t’ju kritikoj pse kanë ndodhur këto rritje, kur edhe vetë i kuptoj se nga kanë ardhur këto rritje. Andaj, dhashtë Zoti edhe vitin e

ardhshëm jemi së bashku dhe, këtë vit do të thotë, arrihet realizimi i buxhetit në tërësi, shumë ma lart se kjo që ka qenë këtë vit 90% ose sa ka qenë, dhe qytetarët e paktë të cilët kanë mbetur, deri në fund të vitit do t'i plotësohen edhe këto mangësi të cilat i kanë. Ju falemnderit!

**Uran Halimi:** Falemnderit, z.Hajredini! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Nedzmidin Sejdilar.

**Nedzmidin Sejdilar:** Përshëndetje të gjithëve, ka ardhur koha që ekzekutivi t'i dorëzojë llogaritë popullit, ku janë paratë dhe si janë shpenzuar paratë. Unë i kam analizuar me kujdes disa gjëra, këtu ka disa paqartësi për të cilat do t'i kërkoja drejtorit përgjegjës të përgjigjet në pyetjet e mëposhtme. Në raportin e shpenzimeve keni shpenzuar rreth 80 mijë euro për shërbimet e kontraktuara, çfarë saktësisht nënkuptohet aty. Këtu përmenden edhe kostot e anëtarësimit rreth 11 mijë euro, më intereson se për çfarë pagese është. Më pas keni shpenzuar rreth 40,000 euro për mobilje me vlerë më pak se 1,000 euro, çfarë lloj mobilie ka qenë dhe çfarë keni blerë? Keni shpenzuar rreth 25,000 euro për kompjuterë që kushtojnë më pak se 1,000 euro, dua të di se ku i keni blerë ata kompjuterë dhe për çfarë qëllimesh. Furnizime mjekësore rreth 68,000 euro. Supozoj se bëhet fjalë për barna, më intereson edhe ku i keni shpenzuar ato fonde. Ju keni shpenzuar rreth 127,000 euro për naftë për ngrohje, pastaj keni shpenzuar rreth 200,000 euro për dru zjarri. Po të marrim parasysh që dimri ishte i butë dhe kostot e energjisë elektrike ishin jonormale, më intereson si keni arritur ta kaloni atë në radhë të parë. Karburanti për agregatet rreth 5000 euro. Unë supozoj se komuna nuk ka më shumë se 10 agregatë, që do të shkonte në 547 euro për agregat. Nëse kemi parasysh që një gjenerator harxhon 1 litër në orë, mendoj se komuna jonë nuk ka qenë për një kohë kaq të gjatë me mungesë të energjisë elektrike. Karburanti për automjete rreth 79.000 euro. Nëse marrim vlerën mesatare prej një euro e gjysmë për litër karburant dhe e ndajmë të gjitha me vlerën mesatare të konsumit të karburantit, ju keni kaluar rreth 600 mijë km me 27 automjete komunale, që do të thotë se nëse llogarisim shpejtësinë mesatare të lëvizjes. në Kosovë prej 80 km në orë, kjo do të thotë se jeni ende duke vozitur. Dhe unë nuk shoh ndonjë rezultat për këtë. Rreth 31,000 për mirëmbajtjen e atyre automjeteve, rreth 37,000 për furnizimin e materialeve të zyrës. Unë supozoj se furnizimet e zyrës përfshijnë letër, tonerë, kimikate dhe të ngjashme. Nëse gjysmën e atij materiali zyre e kthejmë në letër, atëherë nuk e di ku janë arkivat tuaja. Sepse është një sasi e madhe letre. Keni shpenzuar rreth 388.000 për subvencione, keni subvencionuar shumë organizata joqeveritare dhe nga të gjitha ato joqeveritare, vetëm rreth 8.000 euro i keni dhënë organizatave joqeveritare nga Gora. Më vjen shumë keq që shefi i zyrës për komunitete nuk është këtu për të na thënë nëse buxheti i subvencionimit është shpenzuar në përqindje dhe proporcion. I nderuar drejtor, mendoj se qytetarët e komunës sonë e meritojnë t'i përgjigjeni të gjitha këtyre pyetjeve.

**Uran Halimi:** Falemnderit, z.Sejdilar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Fjalën e ka kërkuar z.Mehmet Spahiu nga LDK.

**Mehmet Spahiu:** Përshëndetje! Meqenëse është në shqyrtim edhe debat shpenzimet buxhetore, të cilat kapin një shumë mbi 10 milionë euro, unë desha t'i parashtroj disa pyetje drejtorit, thjesht për

të shuar kureshtjen time, ngase disa gjëra m'u dukën pak si jo të pranueshme. Shpenzimet për mallra dhe shërbime, kodi 13620, në vitin 2022 janë shpenzuar 2,615, po shkoj ma ngadal, në vitin 2021 5,989 euro, ndërkaq në vitin 2020 61,611 euro. Mirëmbajtja e autorrugëve lokale, kodi 1432, viti 2022 2,165 euro, viti 2021 7,700 euro, viti 2020 78,800 euro. Subvencione për përfitime individuale, në vitin 2022 janë shpenzuar 178,667.50 euro, në vitin 2021 103,892 euro, ndërkaq në vitin 2020 542,675 euro. Janë shifra për mu të pakuptueshme. Këto ishin pyetjet të cilat ia parashtrova drejtorit. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Spahiu! Fjalën e ka kërkue z.Samidin Xheladini.

**Samidin Xheladini:** Të nderuar të pranishëm! Unë falënderoj një herë kolegun që aludoi, se është e vërtetë, edhe ju duhet të jeni konkretë edhe kritikues edhe krahasues, sepse është për të mirën e qytetarëve sigurisht. Unë e lexova faqe 11, dhe që më inkurajoi shumë, shikoni tabelën që është rreth dy faqe komplet, shikoni projektet, buxhetin e planifikuar dhe shumën e hargjuar. Shihni, çdo shumë domethënë është, edhe pse ka qenë e planifikuar nga ish-qeveria dhe ka qenë inflacion mbi 35-40%, kjo qeveri ka arrit që t'i kontrakttojë dhe ta kursejë buxhetin e planifikuar në të gjitha lëmitë, në të gjitha projektet asnjë send s'e kam pa askund diku që ka pas pare shtesë në realizim. Edhe është shumë e mirëseardhur, edhe pse ka pas inflacion, shumat e realizume kanë qenë në nivelin e parashikuar. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Xheladini! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Ni minutë replikë z.Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** I nderuar koleg Samidin Xheladini, respekt për ty, ti e di, po na jemi kritikues në momentin kur duhet me kritikue dhe nuk jam tip që, gjërat të cilat i kuptoj, mundohem t'i rris dhe të fitoj ndoshta poena politike, se po dalim këtu, po i paraqes para qytetarëve se është shpenzue më tepër në pagesën e druve për shkolla, kur ne e dimë se çfarë çmimi ka qenë këtë vit blerja e druve dhe çfarë çmimi ka qenë vitin e kaluar. Unë muj me dal tash edhe me bo krahasime edhe me thonë nuk është në rregull, a unë jam tash në opozitë edhe e kam të drejtë, mirëpo atë nuk ma lë ndërgjegja, nuk muj me e bo atë gjest. Unë në momentin që dal këtu e marr fjalën, e marr për diçka të mirë, edhe për diçka që ka bazë, përndryshe nuk e marr dhe nuk dal fare. Ndërsa tjetra që thaje këtu, kjo nuk është, o nuk e ke kuptue, o deshe vetë me e dhënë si lavdatë, tek përshkrimi i projekteve për investimet kapitale, se thaje nga qeveria e kaluar janë bërë planifikime ndërsa shumat kanë arrit t'i menaxhojnë. Dëgjo, ti e dish fort mirë, je shumë mandate, po nuk e di sa je marrë me punimet. Unë katër vitet e kaluar kam nejt me punëkryesit dhe e di si shkojnë këto gjëra. Në momentin që është planifikue, po e marrim shembull këtu ni shumë që është pak ma e lartë, 186 mijë është planifikuar asfaltimi i rrugës Restelicë-Strazimir, edhe janë lëshuar 119,955. Në momentin që kompania i përfundon punimet në tërësi, ashtu si janë planifikuar me projekt, pagesat duhet të kryhen në tërësi. Ndërsa në momentin që komisioni vlerësues e vlerëson si punim të papërfunduar në tërësi, atëherë e jep ni vlerësim se kjo shumë adekuate është vetëm për ato punime

dhe punimet tjera nuk janë përfunduar dhe për atë arsye edhe nuk lëshohen shuma në tërësi e planifikuar. Prandaj nuk është kjo që e dhaje si lavdatë apo si zotësi, po kjo është për moskryerjen e punimeve në tërësi dhe lëshohet vetëm ajo pjesa që mendohet se është kryer punimi në atë projekt. Ju falemnderit!

**Uran Halimi:** Falemnderit, z.Hajredini! Fjalën e ka kërkue kryetari, z.Bexhet Xheladini, dhe pas tij z.Agron Gashi.

**Bexhet Xheladini:** I nderuar kryesues, zëvendëskryesues, delegatë, mjete të informimit! U bë më parë një pyetje rreth subvencioneve. Komuna e Dragashit vitin e kaluar i ka nda diku rreth 400 mijë euro subvencione, dhe atë 100 mijë euro zyra e kryetarit, afër 100 mijë euro Drejtorati për Bujqësi, 50 mijë euro Drejtorati për Arsim, edhe mbi 100 mijë euro i ka nda Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport. Ju e dini që kur ndahen subvencionet, ka shumë subvencione të cilat bëhen me manifestime kulturore, të cilat janë me mjete të përbashkëta, nuk ndahen ato edhe nuk hynë në përqindje. Unë veç due të them se të gjithë ata të cilët kanë kërkue subvencione te zyra e kryetarit, për barna, për sëmundje, për gjëra të tjera, 99% të komunitetit joshumicë që i kanë kërkue, nuk janë refuzue, i kanë marrë. Gjithashtu, te DKA, të gjithë ata studentë të cilët kanë kërkue bursa, asnjë pjesëtar i komunitetit joshumicë nuk është refuzue, pavarësisht a i plotëson kushtet edhe kriteret. Po ashtu, në Drejtoratin e Bujqësisë që janë nda subvencionet, të gjithë aplikuesit e komunitetit joshumicë të cilët kanë aplikue me marrë subvencione në vlerë prej 90 mijë eurosh, kanë marrë subvencione dhe nuk janë refuzue. Edhe në DKRS të gjitha OJQ-të apo shoqatat apo klubet sportive të cilat kanë kërkue subvencione në DKRS nga komuniteti joshumicë, nuk janë refuzue po janë nda, përveç një OJQ-je e cila ka konkurue dy OJQ për një projekt, të dyjave nuk është mujt me iu nda, po i është nda njëri ai projekt, për arsye se është bërë fjalë për një projekt. Mehmeti e përmendi qat shumë 500 mijë euro edhe disa dallime në ndarjen e subvencioneve, këto janë subvencione të cilat në kohën e pandemisë qeveria i ka lëshue paret, nuk janë konë paret e komunës po të qeverisë, edhe pastaj komuna i ka menaxhue edhe i ka nda ato subvencione njerëzve, gjithashtu kanë qenë edhe vërsimet në atë kohë, edhe kjo është ai dallimi mes viteve që është në shumë absurde. Sa i përket druve, ju e dini dallimin e çmimeve të druve, na në fillim kur e kemi marrë pushtetin, për arsye se drutë janë hargjue, kemi ble metrin e druve 37 euro, në fund e kemi ble afër 80 euro një metër dru, ka një dallim ma shumë se qindpërqind, kështu që për atë arsye janë hargjue ma shumë mjete, mirëpo drutë nuk janë hargjue, drutë vetëm janë ble, drutë janë, janë hargjue aq sa ka pas nevojë, duke pas parasysh se dimri ka qenë sivjet ma i butë, dhe në këtë vit na do të blejmë ma pak dru, po ashtu edhe nafta për nxemje është ble, por nuk do të thotë që është hargjue, ajo nafta është, ekziston, edhe normal dallimet në çmime, nga 1 euro sa ka qenë ne e kemi marrë 1.58, kështu që për 0.50 cent ka pas dallim. Sa i përket mjeteve higjienike që po mungojnë, drejtori i Administratës harroi me e thënë, na vitin e kaluar e kemi shpallë në tender dhe është shpallë kompania fituese. Kompania fituese ka hy me në çmim shumë të lirë, edhe në momentin, më 22 dhjetor, ka abstenuë, dhe na më nuk kemi pas kohë me shpallë tender tjetër, se është dashtë me u mbyll viti fiskal. Na atë kompani e kemi dënue, zyra e prokurimit e ka dënue në

vlerë prej 5 mijë euro, aq sa na lejon ligji, edhe këtë vit e kemi shpallë tenderin edhe tash brenda javës të gjitha institucionet do të pajisen me mjete higjienike. Faleminderit!

**Agron Gashi:** Atëherë më lejoni edhe një herë të ju përsëndes! Është fjala te raporti vjetor financiar janar 2022 deri në dhjetor. Në një këndvështrim timin këtu, kur është ndarja proporcionale për fshatra, shoh diçka dhe bëra një përlllogaritje të lehtë, ashtu kalimthi në shpejtësi, dhe shoh prioritetet dhe investimet kapitale që janë bërë sidomos në fshatin Bresanë dhe në fshatrat që pasojnë, fshati më i madh Bresana dhe pastaj rangohet fshati Brezne apo Kuki etj. Llogaritjet e mia më thonë kështu, prioritetet që janë dhënë për vitin e kaluar kapin një shifër prej 265 mijë euro, por kur nxjerrim të dhënat si fshati i dytë fshati Brezne, kap shumë më pak se 100 mijë. Dhe do të thotë se mjetet janë dedikuar mbi 150% ma shumë në fshatin Bresanë. Kjo është ndoshta si pasojë që kryetari po ndodh fati që kryetarët po janë zakonisht të Bresanës, por tashti më lejo të flas edhe për vitin 2023, ku është bë ni balancim ma adekuat, më i duhur, dhe nuk vërehet kjo distancë e lartë në investimet që do të bëhen për 2023 në Bresanë dhe në fshatrat që pasojnë pas saj. Do të thotë në 2023 është planifikuar më mirë dhe kështu që uroj që vitet pasuese, z.Xheladini, t'i jepet përparësi edhe fshatrave të tjera në të cilat mungon e drejta elementare, mungon uji, mungon kanalizimi, mungojnë gjërat më të thjeshta të mundshme, ndërsa në vendet e tjera po mendojnë në bjeshkë për të gatuar fli apo diçka tjetër. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Gashi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Nëse s'ka, atëherë fjalën po e kërkon drejtori i Administratës ose përkatësisht u.d. i Drejtorisë së Arsimit.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Meqenëse njëren pjesë po e lëmë drejtori i Ekonomisë dhe Financave që të përgjigjet, sa i përket, diskutuam në foltore në lidhje me shpenzimet dhe mallrave dhe shërbimeve sipas viteve, më saktësisht në kodin 13503, sa i përket kompjuterëve po filloj me radhë, sa i përket pajisjeve me kompjuter – po, faqe 7 kodin 13503 – për dallim nga viti 2021, kur kemi pas ni shpenzim prej 11,329 euro, në vitin 2022 kemi pas ni ngritje në 25,493 euro. Kjo vjen si pasojë e furnizimit ashtu siç e kam cek edhe në raportin e punës, vjen si pasojë e furnizimit me pajisje moderne të IT-së për më shumë se gjysmën e administratës komunale. Realisht kjo shumë do të ishte edhe më e lartë nëse do të premtonte koha dhe kontrata me AQP-në nuk do të shkëputej qysh në muajin tetor, dhe atëherë do të bëhej furnizimi i tërësishëm edhe i pjesës së mbetur të administratës komunale. Faktor tjetër përcjellës është edhe ngritja e çmimeve në bursën botërore sa i përket pajisjeve të teknologjisë dhe çdo çmimi tjetër. Sa i përket kodit 13610, furnizime në zyre, edhe pse në vitin 2022 kemi më pak shpenzim sesa në vitin 2021, përkatësisht nga 48 mijë në 37 mijë, ne kemi arritur që të sigurojmë një stok të mjaftueshëm, qoftë të materialeve zyrtare, qoftë të letrës, gjithashtu kemi edhe furnizimin me letër speciale e cila përdoret nga zyra e gjendjes civile, për dallim nga vitet e kaluara ku kemi pas probleme të jashtëzakonshme, si pasojë e krizës me nivelin qendror, pra letër speciale Komuna e Dragashit aktualisht ka në stok afërsisht 35 mijë kopje, e që e bën Komunën e Dragashit ta ketë luksin që të huazojë edhe komunave tjera brenda territorit të RKS. Unë flas me fakte, kemi edhe dëshmi,

Komunës së Suharekës i kemi huazuar para tre muajsh afër 6 mijë copë letër speciale e cila përdoret për zyrën e gjendjes civile, që do të thotë se ne kemi arritur që t'i mbushim stoqet tona, në mënyrë që të jemi të përgatitur për çdo eventualitet sa i përket krizës dhe qytetarët tanë të mos rrezikojnë të mbesin pa shërbime të cilat iu nevojiten. Sa i përket kodit 13640, furnizime pastrimi, ashtu siç po e shihni edhe në grafikun, nga 17 mijë kemi ra në 5,499, kjo është si pasojë e furnizimit një herë që e kemi bërë me material higjienik, meqenëse ne në momentin që është bërë ndryshimi i qeverisjes lokale, praktikisht në datën 6 prill, nëse nuk gaboj, ka skaduar kontrata e kompanisë e cila ka qenë e kontraktuar për furnizimin me material higjienik. Dhe si pasojë e kësaj gjendemi në një situatë të tillë, ne kemi kërkuar që të bëjmë një furnizim të njëhershëm në mënyrë që të kemi stoqe për tërë vitin, dhe pikërisht kjo vlerë është vlera e cila është paguar për të marrë furnizimin për një vit. Sa i përket naftës për ngrohje qendrore dhe dru, besoj nuk ka nevojë meqenëse kryetari i komunës e ilustroi mjaft mirë ngritjen e çmimeve, e sidomos kur kemi blerë, ashtu siç e kemi diskutuar në seancën paraprake me profin Nexhat Selaj, sa i përket furnizimit të vonshëm, meqenëse është bërë furnizimi me vonesë, edhe çmimet kanë qenë të fundvitit, që nënkupton çmimet kanë qenë astronomike. Dhe kjo reflektohet më mirë edhe në sasinë e mjeteve të cilën e kemi paguar. Sa i përket karburanteve me vetura, u apostrofua këtu se janë bërë 600 mijë kilometër afërsisht, që duhet të them me gjithë respektin, është një manipulim i pastër. Arsyeja po mundohem ta ilustrtoj. Për të gjithë këto shpenzime Drejtoria e Administratës posedon për secilin automjet bllokun e vozitjes, ku duhet të shënohen kilometrazha sa merret dhe kilometrazha pas kthimit. Shënohet data, arsyeja ku shkon vetura zyrtare dhe personat të cilët gjenden në veturë zyrtare gjatë transportit. Dhe kjo gjë lë gjurmë në të gjitha shfrytëzimet e automjeteve zyrtare, shtuar kësaj edhe kërkesën e cila duhet të drejtohet pranë DA-së, kërkesë ku secili, qoftë shfrytëzuesit të jenë nga zyra e Kuvendit, përkatësisht asambleistët, kryesusi, drejtorët, kushdo tjetër që është staf komunal, aty figuron arsyeja ku ka qenë dhe çka ka vijuar. Kështu që manipulimi më këtë ndalet. Sa i përket anës tjetër, përveç këtyre karburanteve për vetura, duhet theksuar se në këtë kaptinë të shpenzimeve hyn edhe transporti i nënësve të komunitetit. Janë dy autobusë, është një veturë e cila bën transport, dhe përkatësisht, përmes kësaj, ne mund të themi me gojën plot se ne i ndihmojmë edhe komunitetin, nuk është e vërtetë se të gjitha shpenzimet janë nga pjesa shqiptare. Ato shpenzime të autobusit, kur e dimë që autobusi shpenzon më shumë sesa automjeti zyrtar, ato të gjitha janë të reflektuara këtu. Pastaj, regjistrimi i automjeteve, sigurimi i automjeteve dhe taksë për regjistrimin e automjeteve. Edhe kodi i fundit është 14010, është mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve. Në momentin kur është bërë evidentimi i tërë automjeteve zyrtare nga zyrtari i pasurisë, ne kemi gjetur se ka automjete të cilat kanë të skaduar afër tetë muaj regjistrimin. Një institucion i cili supozohet që të jetë shembull si zbatohet ligji edhe rregulloret, ne kemi gjetur të paregjistruara. Normalisht se i kemi regjistruar të gjitha, i kemi siguruar të gjitha, kemi gjetur vetura të cilat nuk kanë qenë as të doganuara, mund të jap edhe me shembuj, është për shembull vetura e QKMF-së, Mitsubishi L 200, e cila ka qenë donacion nga Ambasada Amerikane dhe nuk e ka parë dritën e diellit për disa vite, derisa ne kemi kontaktuar me ambasadën dhe kemi arritur që ta doganojmë. Pra, shpenzimet për mirëmbajtje gjithashtu përfshijnë edhe kamionin të cilin e ka në menaxhim Agjencioni për Menaxhimin e Mbeturinave. Vetëm fatura e fundit e cila është



sjellur nga departamenti i zjarrfikësve, ku duhet theksuar se është i vetmi kamion të cilin e kanë ata në shfrytëzim, 2,888 euro servis, i shkaktuar si pasojë e daljes në teren për pastrimin e rrugëve gjatë dimrit, po flas gjithmonë për vitin e kaluar. Pastaj, sa i përket taksave, janë vlera fikse, ne nuk i diktojmë ato vlera, ato shkojnë konform madhësisë së mjetit motorik dhe dosjes së aksidenteve. Janë vlera fikse të cilat neve vetëm na gjeneron sistemi edhe i paguajmë. Shpresoj në mirëkuptimin tuaj, faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar z.Edin Kurt dhe pas tij një minutë replikë z.Nedzmidin Sejdilar.

**Edin Kurt:** Ne nga komuniteti goran, që nuk e kuptojmë gjuhën shqipe dhe që përdorim kufje, kemi problem me përkthimin. Ne nuk mund të kuptojmë gjithçka që thonë kolegët tanë. Kolegu që është në kabinë, besoj se është i ri dhe besoj se i duhet pak kohë që të përshtatet dhe të marrë ritmin. Jemi në një situatë ku nuk kuptojmë gjysmën e gjërave. Nëse mund të zgjidhet ky problem.

**Nedzmidin Sejdilar:** Ndërsa unë u ndjeva i thirrur kur thatë se karburanti kushton, kur thatë se zotëria që bëri pyetjen për karburantin synon të manipulojë opinionin publik. Unë, zoti drejtor, po bëj një pyetje në bazë të asaj që më keni dhënë në këtë raport. Nëse në këtë raport shkruhet se kostot e karburantit janë rreth 79.000 euro dhe kur e ndajmë atë me çmimin që thatë pak më parë rreth 1.59 euro, fitojmë më shumë se 50.000 l karburant keni harxhuar. Ndoshta ata autobusë që transportojnë fëmijë nga komuniteti jo shumicë kane shpenzuar ato 45 mijë litra.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, zëvendëskryesues! Edhe unë nuk desha të replikoj, mirëpo meqenëse po kërkon informacione edhe më detale, sa i përket shpenzimit të kësaj naftë, harrova ndoshta edhe me cek, nuk do të dilshe në replikë fare, ne kemi bërë një marrëveshje mirëkuptimi me KFOR-in Turk, dhe përmes kësaj marrëveshje, ata kanë mundësuar hapjen e rrugës së re për ta aktivizuar stadiumin e Graniqarit, një kërkesë e kahmotshme edhe e Asamblesë këtu. Si pasojë e kësaj është arritur një dakordim që komuna, meqenëse nuk ka mjete dhe nuk ka planifikuar hapjen e asaj traseje, ta financojë hapjen e kësaj rruge përmes furnizimit me derivate. Derivati ditor, unë këtu kam sjellë edhe faturat, kërkesat dhe procesverbalin për secilën herë, çdo transaksion që është bërë nga KFOR-i Turk, dhe shuma minimale e shpenzuar për hapjen e kësaj rruge është 5,500 litër. Vetëm me një aktivitet janë shpenzuar 5,500 litër. Këtë e kam marrë vetëm si ilustrim që të dihet se ku po shkojnë, ne jemi të hapur për çdo llogaridhënie për secilin moment dhe për secilin projekt, dhe çdo nënshkrim ku ka vendosur drejtori i Administratës, e besoj edhe e gjithë qeverisja lokale. Përndryshe për çdo sqarim apo dyshim tuajin jemi të hapur çdo ditë, diskutojmë. Asgjë të cilën ne e bëjmë nuk mund të jetë sekrete për Asamblenë Komonale, një bashkëpunim i mirëfilltë mes nesh është më mirë edhe për ne, edhe ne qeverisim më mirë. Por duhet theksuar, i vetmi argument, meqenëse shpenzimi ditor i pajisjeve të KFOR-it Turk është 330 litër. Në momentin kur kanë ardhur dy mjete, sepse fillimisht është përdorur një buldozher për ta shqyer trasenë, shpenzimi ka

qenë 330 litër, në momentin kur ka ardhur edhe glederi, ai mbrapa buldozherit, në sasi ditore jemi detyruar që të furnizojmë me 660 litër. Këtë e dëshmojmë me procesverbal, me gjithçka, jana të bashkëngjitur memorandumit i mirëkuptimit dhe gjithçka tjetër. Faleminderit shumë!

**Nexhat Selaj:** Përshëndetje edhe ni herë! Drejtor me vëmendje të dëgjova, qetu deshte m'u arsyetue pak, po para qytetarëve duhesh të jesh japësh llogari pak. Thaje se furnizimi me dru, pelet, lëndë djegëse janë sjellë me vonesë, dhe ishte ngritja e çmimeve që boni ni shumë kaq të lartë. Ne nuk jemi fajtorë për këtë, ju keni deklaruar se furnizimet do të kryhen shumë më herët nga qeveria paraprake, dhe kjo vonesë bartet si barrë e juaja pse drutë kanë ardhë në nëntor dhe dhjetor dhe çmimet kanë qenë të larta, kështu që këtu deshta veç pak të arsyetoj, pasi që e kemi kalue dhe disa herë e kemi folë këtë temë, nuk deshta të ndalem, po vetëm deshta të sugjeroj se nuk është faji i yni, është faji i juaji, tash ju me kontraktorët si e keni pas me furnizuesit, ajo është diçka tjetër. Veç kaq, faleminderit!

**Samidin Xheladini:** Të nderuar delegatë, faqe 7 kemi edhe pasqyrat e hargjimeve të viteve paraprake, edhe më kanë ra në sy edhe gjithnjë i kam analizue, po pse nuk po i shihni do kursime enorme, për shembull te shërbimet kontraktues tjera prej 93 mijë në 80 mijë, mobilje më pak se 1 mijë euro nga 53 mijë në 40 mijë, pajisje tjera prej 250 mijë në 49 mijë, furnizim me material zyre nga 48 mijë në 37 mijë, dreka zyrtare nga 62,615, furnizime mjekësore nga 243 mijë në 68 mijë, furnizime pastrimi nga 30 mijë në 5,499, naftë për ngrohje qendrore nga 141 mijë në 127 mijë edhe pse janë rrit çmimet, edhe mirëmbajtja e rrugëve lokale nga 78 mijë në 2,160 etj. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Xheladini! Të nderuar delegatë, meqenëse u shterë çdo diskutim, po e hedhim në votim. Kush është pro pikës së dytë të rendit të ditës? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë, konstatoj që me 12 vota pro, me 1 kundër edhe 10 abstenime kalon edhe pika e dytë e rendit të ditës. Të nderuar delegatë, ju lus që ta marrin një pauzë deri në ora 13:30.

**Uran Halimi:** Sa për informacion, në lidhje me rregulloren për dhënien në shfrytëzim për më pak se një vit të pronës së paluajtshme të komunës, unë ju njoftoj që kjo rregullore është përpiluar edhe, në fakt ka të drejtë ekzekutivi që me e bo rregulloren vetëm se duhet miratimi i Kuvendit. Është servue nga zyra e kuvendit në mënyrë të ligjshme dhe ju ftoj ta merrni fjalën përpara se ta hedhim në votim. Nëse jo, atëherë e hedhim në votim, kush është pro kësaj rregulloreje? Kush është kundër? Abstenim? Konstatoj që me 15 vota pro, me 1 kundër edhe me 6 abstenime, kalon pika e tretë. Para se të kalojmë te pika eventuale, e kemi edhe propozimin nga z.Mehmet Spahiu për formimin e komisionit për përzgjedhjen e drejtorëve të shkollave, nëse do dikush me e marrë fjalën në lidhje me këtë pikë? Dy minuta derisa të shpërndahet materiali në lidhje me këtë pikë të cilën e kemi fut ma herët në rend të ditës.

**Nedžmidin Sejdilar:** Do të kërkoja nga drejtori që të ma jepte këtë material të përkthyer, sepse nga ky nuk kuptoj asgjë.

**Uran Halimi:** Nëse do dikush tjetër me e marrë fjalën përpara se ta hedhim në votim këtë propozim? T'i japim pak kohë grupit parlamentar të PDK-së, po ju duhet pak kohë.

**Driton Ademi:** Faleminderit, kryesues! Deshta me e ditë te pika e dytë, nuk kam personale kurgjo, veç unë e di që janë t'u procedue këto këshillat e prindërve, nuk e di a është i zgjedhur apo u krye përzgjedhja e tij, edhe deshta me ditë mandatin sa e ka qeky komision? Një vit. Po mirë, për qato deshta me lidhë, se nëse i ka dalë mandati Ajazit, atëherë duhet me zëvendësue me dikë tjetër.

**Uran Halimi:** Sa për informacion, këtu duhet të jetë jo një vit, po një vit shkollor, a po kupton, e ke harrue me shkruie fjalën një vit shkollor. S'është e vërtetë a, okej.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Sa i përket mandatit, nuk shkruhet një vit shkollor, për arsye sepse në procedurat e DKA-së nuk kanë rëndësi vitet shkollore, është i rëndësishëm viti kalendarik, për këtë arsye ka mandat njëvjeçar. Ndërsa sa i përket z.Ajaz Myrtezanit, ai është arkëtar i këshillit të prindërve në shkollën e fshati Blaç, është i zgjeëdhur arkëtar në shkollën fillore 'Ilmi Bahtijari'. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Në rregull, fjalën e ka kërkuie z.Nexhat Selaj.

**Nexhat Selaj:** Faleminderit edhe një herë! Tek anëtarët, të parin edhe të dytin, tek anëtari i dytë deshta të ndërlihem, mos jemi diçka kundërligjore. Veç deshta të pyes, për arsye se s'po muj me ditë se mos është ngrit kallëzim penal, mos po gabojmë diçka.

**Uran Halimi:** Fjalën e ka kërkuie z.Shpetim Hajredini dhe pas tij Jetmir Ajdini.

**Shpetim Hajredini:** Atëherë përshëndetje edhe një herë për të gjithë! I nderuar drejtor Vetim, tash na sollët dy materiale në këtë seancë, e para është udhëzimi administrativ edhe kalojmë direkt në pikën 9, neni 6, ku po e sqaron dhe po e jep shumë detajisht, komisioni përzgjedhës caktohet për një konkurs, për institucione arsimore që janë në varësi të komunës, me propozim të DKA-së. Anëtarët e komisionit nga DKA mund të caktohen nga Kuvendi Komunal për një vit shkollor. Unë nuk jam gabim se po e shoh mirë qetu, edhe po e lexoj mirë. Ndërsa materiali tjetër që na u pru tash, propozimi për emërimin e komisionit për përzgjedhje, nënshkrimi i juaj qenka, do të thotë mandati i komisionit do të zgjasë për një vit kalendarik ti thaje, viti kalendatik fillon me 01.01. të një viti, përfundon më 31.12. po të atij viti, viti shkollor fillon me sa e di unë më 01 shtator edhe përfundon në qershor. Nuk është e njëjtë. Qetu thashë veç mos u bone, mos të kemi problem me ligjin, sa i përket nga ana ime, nuk ka kurrfarë... po po, në rregull është, po viti shkollor edhe viti

kalendariq dallojnë, duhet të jemi të qartë, të mos kemi probleme me ligjin, përndryshe asgjë s'kam të bëj kundër kësaj.

**Uran Halimi:** I nderuar drejtor, viti shkollor përfundon më 31 gusht, ndërsa viti kalendarik përfundon më 31 dhjetor, nuk janë të ngjashme këto, nëse ke bo gabim teknik mundesh me e përmirësue, sa i përket ngjashmërisë mes këtyre dyve, është dallim i madh.

**Vetim Ramadani:** Sa i përket nenit 6, komisioni përzgjedhës, procesi i përzgjedhjes së drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në IEAAP, koordinohet nga DKA, MASH etj. Pika e tretë thotë komisioni përzgjedhës, jo për një konkurs që thatë, është komisioni përzgjedhës për institucionet arsimore, në të gjitha shkollat që janë në varësi të komunës, ka këtë përbërje: dy anëtarët të komunës të cilët propozohen nga DKA dhe miratohen nga Kuvendi Komunal, e shpjegon anëtari i parë, i dytë, i tretë. Anëtari i komisionit i punësuar nga DKA, njëherit është edhe kryesues i komisionit. Një anëtar nga MASHT i cili përcaktohet nga MASH, pasi që ka marrë njoftim zyrtar nga DKA, që shihet në projekt-propozim. Në cilën pikë të UA-së e ke fjalën? Nuk është telashe, veç ta diskutojmë, nuk është problem. Në faqe 90. Këtë pjesën pika nëntë, komisioni përzgjedhës a po, caktohet për një konkur për institucionet arsimore që janë në varësi të komunës, me propozim të DKA-së, anëtarët e komisionit të DKA-së mund të caktohen nga Kuvendi Komunal për një vit shkollor. Për të mbështetur punën e komisionit përzgjedhës, MASH përgatit udhëzues të veçantë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi të këtij vendimi. Në rregull, nuk është problem, mund të jetë edhe gabim, e përmirësojmë, po nuk është telashe absolut.

**Uran Halimi:** Faleminderit, drejtor! Unë e kam veç një paqartësi këtu, te anëtari i dytë po thotë që duhet me qenë përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune. A është personi në fjalë përfaqësues i prindërve në nivel komune? Po a, në nivel komune, okej. Po vazhdojmë pra, dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Të nderuar delegatë, ata që dojnë me e marrë fjalën duhet në foltore me dalë me folë. Fjalën e ka kërkue ma herët z.Jetmir Ajdini, pas tij fjalën e ka Driton Ademi edhe më pas Nedzmidin Sejdlar.

**Jetmir Ajdini:** Përhëndetje edhe ni herë! Unë po menoj që për shkak të qetyre paqartësive që janë, e propozova në fillim që kjo pikë e rendit të ditës me u shty për seancën e ardhshme. Me e pas materialin asambleistët, me pas emrat e qetyre anëtarëve të komisionit, me i shqyrtue para seancës. Momentalisht unë po e shoh që kemi secili paqartësi qetu, se nuk ka kurgjo të keqe, ajo është diçka ligjore që duhet me u formue, po...pse me na kthye MAPL ligjshmërinë ose mos me na kthye, është një komision që e formojmë, e votojmë. Unë po mendoj që ka shumë paqartësi në shumicën e kolegëve asambleistë, kështu që ish konë mirë me e shty për seancën e ardhshme.

**Driton Ademi:** Falemindeti, kryesues! Edhe ni herë po kthehem, Vetim, te pika e nëntë. Ajaz Myrtezani a është anëtar në shkollën fillore Blaç, apo është në nivel komunal? Edhe pyetja e dytë, nëse ka të kalume diçka, domethënë në proces, pa marrë parasysh, atëherë kjo na kthehet mbrapa

neve. Po mirë, pse na me e pru me në seancën e ardhshme...aty s'mundish me e ditë. Unë po të pyes ty. Po s'mundi unë m'u konë anëtar i këshillit të prindërve në Bresanë, edhe me ardhë sot në Dragash, kurse nuk jam anëtar i këshillit qendror komunal. Qeto po due me ma sqarue veç. A je anëtar i këshillit të prindërve lokalë në Bresanë, në Blaç konkretisht, apo je në nivel qendror këtu komunal. Nuk e kam unë për diçka tjetër.

**Nedžmidin Sejdilar:** Të nderuar delegatë, kjo pikë është një shembull klasik i joseriozitetit së pushtetit ekzekutiv. Në fillim duhej ta shtynim këtë pikë për një seancë tjetër, për t'iu qasur më seriozisht krijimit të këtij komisioni. Këtu ju tregoni se keni vota dhe se mund të bëni çfarë të doni. Në fillim thashë që nëse unë si delegat i opozitës do të kisha ardhur në këtë foltore dhe do të propozoja një ndryshim të rendit të ditës, do të kishte kuptim, por ju jeni qeveria. Ju e përgatitët këtë agjendë së bashku me kryetarin e kuvendit, pse nuk e keni bërë në kohën e duhur dhe nuk na e keni dorëzuar materialin që ta shqyrtojmë tani. Kjo është e ngjashme me një punëtor që përgatitet të punojë në një furrë buke dhe vesh atë kostumin e bardhë për të punuar me brumin dhe kur të hyjë në punë detyra e tij është të qepë batanije për fëmijë. Kështu duket me ne. Këtu, duke demonstruar fuqinë tuaj politike, duke pasur vota në kuvend, po na detyroni të formojmë një komision që nuk e kemi shqyrtuar, as nuk e dimë si dhe çfarë. Këta anëtarët që u propozuan në komision, a kemi biografinë e tyre? A e dimë kush janë këta njerëz. Thjesht, këtu duhet të punojmë ashtu siç dëshironi të votojmë dhe të përfundojmë. Nuk kisha ndërmend të flisja, por nuk mund të rrija e të heshtja dhe ta lija popullin ta shikonte këtë dramë, sa të papërgatitur vijmë në seancën e Kuvendit.

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Sejdilar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Atëherë një përgjigje po do me dhënë Vetimi në lidhje me Driton Ademi çka tha.

**Vetim Ramadani:** Faleminderit, kryesues! Driton, e bëra me dije edhe ma herët, është arkëtar i këshillit të prindërve në shkollën fillore 'Ilmi Bahtijari' në fshatin Blaç. Propozimi nëse nuk qendron, mundish me shkue me e kontrollue, edhe hajde na trego. Po nuk je auditor o burrë ti, as unë, kam të drejtë në cilësinë e u.d. të drejtorit të DKA-së me ia bo propozimin Asamblesë, kjo është e drejta jeme, e kam dërgue propozimin, në momentin që ka diçka tjetër që del rrugës...a është personi tjetër, z.Faton Nafezi, a është anëtar i komisionit, kush garanton që nesër munden me e krye ni akt jo konform ligjit, edhe na mundim me ndalue.

**Uran Halimi:** E ke keqkuptue, nuk është problemi te personi në fjalë, mirëpo këtu po shkrun, veç ta qartësojmë, mos e merr personale, po shkrun që duhet m'u konë përfaqësues nga këshilli i prindërve në nivel komune.

**Vetim Ramadani:** Të gjitha shkollat, këshillat e prindërve të të gjitha shkollave janë përfaqësues në nivel komune, theksohet ni anëtar, nuk specifikohet që duhet me qenë anëtar.

**Uran Halimi:** Ky a është përfaqësues i këshillit të prindërve a është arkëtar?

**Vetim Ramadani:** Kryesues, ta shtrojmë kështu ma mirë muhabetin edhe diskutimin. Këtë propozim-vendim, nuk është, edhe nëse e merr pëlqimin nga Asambleja Komunale, ne duhet ta dërgojmë pranë MASHT, sepse na e dërgojnë ata ni anëtar tjetër. Në momentin që e dërgojmë vendimin, personat në fjalë duhet të bashkëngjesin CV-të e tyre, në mënyrë që unë t'i dërgoj në ministri, dhe të tregojnë pozicionet që i dëshmojnë që i kanë, kështu që kjo gjë është kontrolli ma i mirë që mund me ndodhë për këtë proces. Unë tregova, po është fjala ime kundër tuajës,

**Uran Halimi:** Ti s'po e thuesh qeto, o drejtor. Ti nëse thuesh ky është përfaqësues i këshillit të prindërve në nivel komune, na jemi në rregull, ti po thuesh diçka tjetër.

**Vetim Ramadani:** Ky është përfaqësues i prindërve në nivel komune, konform udhëzimit administrativ.

**Uran Halimi:** Faleminderit, qekjo na u desht. Po vazhdojmë me e qit...okej, ni minutë të lutem z.Selaj.

**Nexhat Selaj:** Përshëndetje edhe ni herë! Po më vjen keq, Vetim, me t'u drejtue, por i kësaj fushës nuk je, s'po të them s'po marrish vesh, po qaq po e dish rregulloren. Të gjitha shkollat fillore kanë kryesi të vetat, kanë përfaqësues të vet. Përfaqësuesit e të gjithë shkollave emërojnë përfaqësuesin komunal. Në UA pyetet, jepet sqarim, kërkohet, ndoshta kërkohet pak ndihmë, mundish me na dhënë sqarim, kërkohet që të është anëtar qendror. Nëse ai është anëtar nga shkolla fillore 'Ilmi Bahtijari' në Blaç, këtu është gabim. Nëse është anëtar qendror, atëherë është me të drejtë. Nëse nuk ke informacion, lirisht mundesh me pyet, pyet, s'është problem, po presim 5 minuta, 10 minuta, pyet, merr sqarim edhe na jep njoftim. Nuk e kam për ndonjë revansh apo diçka, po e di shumë sigurt se të gjitha shkollat kanë përfaqësuesin e vet, ata përfaqësues e zgjedhin përfaqësuesin qendror. Këtu, në bazë të këtij nenit, kërkohet përfaqësues qendror. Edhe ai është në nivel të komunës, po përfaqëson nga një shkollë. Nuk kemi kundër asgjë, po mos të gabojmë. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Selaj! Dikush tjetër s'ka mo që po do me e marrë fjalën? Agron Gashi.

**Agron Gashi:** Atëherë edhe një herë ju përshëndes! Në pikën 3.1 që e sollët më herët thotë kështu: dy anëtarët e komunës të cilët propozohen nga ana e DKA-së dhe miratohen nga Kuvendi Komunal, anëtari i parë është një përfaqësues nga DKA-ja, ndërsa anëtari i dytë, jep tri mundësi se kush mund të jetë, një thotë të jetë një drejtor shkolle, dy thotë të jetë një ekspert me performancë të lartë, dhe nën tre citon se mund të jetë nga këshilli që përfaqëson në nivel komunal. Dhe nuk ka shumë dilema rreth asaj se çka po debatohet kaq shumë. Tashti DKA-sa, në fakt ekzekutivi

komunal ka nxjerrë kandidatët të cilët na i solli në dorë, dhe nëse ndodh ndonjë gabim, këto kthehen prapë dhe asgjë të keqe s'ka hiç.

**Uran Halimi:** Faleminderi shumë! E ditëm na këtë. Sidoqoftë, po e hedhim në votim këtë propozimin me këta anëtarët të cilët na janë servue. Kush është pro kësaj pike të rendit të ditës, realisht, kush është pro këtij propozimi? Kush është kundër? Abstenim? Atëherë, i kemi 13 vota pro, 7 kundër edhe 2 abstenime. Të presim prej MAPL çka po na thonë. Sidoqoftë, faleminderit shumë! E kemi edhe pikën eventuale. Nëse do me e marrë fjalën dikush me debatue në lidhje me ndonjë çështje? Nëse jo... po, e ka kërkuë fjalën z.Sejdilar.

**Nedžmidin Sejdilar:** Zoti Kryesues, nuk e di nëse ju shërben mirë kujtesa, por në seancën e fundit, kur diskutuam për kalimin e fondeve nga viti 2022 në 2023, ju nuk e hodhët në votim propozimin tim. Unë kisha një propozim të qartë për rialokimin e fondeve, dhe ju më pas thatë me cinizëm se do ta hidhnit në votim atë propozim në fund të pikës. Ndjem i diskriminuar për atë veprim tuaj dhe më vjen shumë keq që zoti Jonuzi nuk është këtu, sepse vetëm z. Jonuzi si zv.Skryesuesi ka të drejtë t'i japë çdo vendimi në interpretim kushtetues. Por unë do t'ia kërkoj me shkrim dhe me të vërtetë kërkoj që të ndryshohet padrejtësia që më bëret.

**Uran Halimi:** Falemindertit, z.Sejdilar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? E ka kërkuë fjalën z.Shpetim Hajredini.

**Shpetim Hajredini:** Ta shfrytëzoj këtë moment, pasi jemi edhe dy ditë afër muajit të madhërisëm të Ramazanit, urime muaji i madhërisëm i Ramazanit, agjërime të lehtë dhe të pranuar, ishalla fillojmë pas Ramazanit me punë dhe këmbë të mbarë!

**Uran Halimi:** Faleminderit, z.Hajredini! Gjithashtu ju uroj edhe unë muajin e shenjtë të Ramazanit, agjërime të lehtë dhe të pranueshëm, mirë u pafshim pas festës së...në fakt ju uroj edhe festën e Bajramit këtu, e shihemi kismet pas festës së Bajramit!